

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"INVEST BUILD" Shpk

Ortakët themelues:

Kavaje 23.03.2023

1. Afrim Sheremet Alija lindur dhe banues ne Kosove ID 0929924
2. Hekuran Skender Haxhimusa lindur dhe banues në Kosove me nr ID 2067439

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 22.03.2023 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

- 1.1 Shoqëria tregtare mban emrin "INVEST BUILD" shpk
- 1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

- 2.1 Shoqëria tregtare "INVEST BUILD" shpk,ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

- 3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "INVEST BUILD" shpk do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje - Qerret Rruga Pavaresia e Kosoves zona kadastrale 31/01 nr 139

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare ne fushen e nderimit objekteve civile dhe publike.

NENI 5

Kohëzgjatja



5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "INVEST BUILD" do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare "INVEST BUILD" shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "INVEST BUILD" Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "INVEST BUILD" Shpk është 100.000 (një qindemije) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- Z. Afrim Alija është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë.
- 2- Z. Hekuran Haxhimusa është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5(Pese)vjet. Kompetencat e adminsitratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është Z.Afrim Alija lindur Likoc Kosove dhe Banues ne Prishtine, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numë .

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

INVEST BUILD Shpk

Afrim Alija



Hekuran Haxhimusa

